



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A. nr. 426/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharremi Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

LDD-së, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2500 (dymijepesëqind) Euro, te cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 11.12.2010, nga subjekti politik AKR më te cilën pretendon se me date 08 dhjetor 2010 në rrugën Luan Haradinaj në Prishtinë anëtarët e subjektit politik LDD kanë vendosur posterin e kandidates për deputete Resmije Juniku mbi posterat e kandidatëve të Koalicionit për Kosovën e Re, e qe është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterin e kandidates për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Resmije Juniku, nga radhët e subjektit politik LDD, është vendosur mbi posterat e Muzejene Selmani, Avni Dervishi, Behgjet Pacoli dhe Shefki Avdullahu që të gjithë kandidatë nga rradhët e Koalicionit për Kosovë të Re. Parashtruesi i ankesës propozon qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Fillimisht PZAP kishte pranuar ankesën me numër A 370 më datë 9.12.2010, kurse më 10.12.2010 PZAP ka kërkuar në bazë të Nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it nga AKR që të bëj plotësimin e ankesës me numër A 370/2. Më datë 11.12.2010, PZAP kishte pranuar nga ky subjekt politik plotësimin e ankesës nga AKR me numër A 426.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LDD, më datë 20.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 21.12.2010, gjerë në ora 16:00. PZAP-i, pranoi përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik LDD, në të cilën theksohet se; vendosjen e posterit në fjalë nuk e kanë bërë kandidatja e këtij subjekti politik, sipas përgjigjes në ankesë, ankesa është e pabazuar për shkakun se kandidatja Resmije Juniku mohon se posterat e saj janë vendosur me dijen e saj mbi posterat e kandidateve të subjekteve tjera, sigurisht këtë akt të papërgjegjshëm e kanë bërë persona të panjohur me qëllim të njollosjes së subjektit tonë, prandaj kërkojmë që ta shqyrtoni këtë përgjigjeje në ankesë dhe të merrni të gjitha masat e duhura ligjore

Përgjigjes në ankesë subjekti politik LDD nuk i ka bashkangjitur asnjë provë që tregon se ky subjekt politik ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;

- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i vlerëson se subjekti politik LDD shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur edhe më parë andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjorbë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim te nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 426/2010 më datën 23.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

